

NJOFTIM PËR SHTYP DATË 23.09.2022

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë elektrike, ndër të tjera u shqyrtua kërkesa e shoqërisë FSHU sh.a lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj.

Mbas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Bordi i ERE-s pranoi pjesërisht kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a, duke vendosur të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë prej 42 lekë/kWh, nga ai i kërkuar prej 42.95 lekë/kWh nga shoqëria FSHU sh.a.

Ky çmim do të jetë i aplikueshëm për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor 2022 dhe do të ketë efekte vetëm për fashën e konsumit mbi 800 kWh/muaj. Për të gjithë klientët familjarë, sasia e energjise prej 800 kWh e konsumuar gjatë çdo muaji, do të mbetet e njejte pra 9,5 lekë/kWh.

Bordi i ERE-s gjithashtu kërkoi nga shoqëritë OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. që periudha e leximit periodik të matësit të energjisë elektrike të klientëve familjare, duhet të kryhet duke respektuar në mënyrë rigoroze afatin prej 30 ditësh kalendarike, të përcaktuar në nenin 11 të “Kushteve të përgjithshme të kontrates së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, me qëllim mbrojtjen e të gjithë klientëve familjarë nga çdo abuzim i mundshëm i leximit dhe faturimit të konsumit të energjisë elektrike.

Kjo vendimmarrje e Bordit të ERE-s, ka ardhur duke marrë në konsideratë vetëm ndryshimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së klientëve familjarë nga shoqëria FSHU sh.a, energji e cila sigurohet nëpërmjet shoqërisë publike të prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a, në zbatim të VKM nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. Asambleja e përgjithshme e aksionarit të KESH sh.a. me vendimin nr. 6645/1, datë 08.09.2022, ka miratuar:

- Çmimin e shitjes së energjisë elektrike ndaj shoqërisë FSHU sh.a për mbulimin e konsumit të klientëve familjarë, mbi 800 kWh/muaj, prej 34.3 lekë/kWh.

Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria FSHU sh.a., për sasinë e konsumuar nga klientët familjarë mbi 800 kWh/muaj prej 34,3 lekë/kWh, do të rrisë kostot e blerjes së energjisë për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022 me rreth 1.8 miliard Lekë, e për rrjedhojë koston vjetore të blerjes së energjisë për vitin 2022 të shoqërisë FSHU sh.a..

Tarifat e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, mbeten të pandryshuara, siç miratuar me vendimet e Bordit të ERE nr. 72/2022 dhe nr. 73/2022.

ERE në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pas analizimit të kostove shtesë të blerjes së energjisë elektrike vlerësoi që çmimi i shitjes së energjisë elektrike për konsumin familjar mbi 800 kWh/muaj, të jetë ai prej 42 lekë/kWh. Ky çmim, mundëson rekuperimin e kostove të blerjes së

energjisë elektrike për pjesën e mbetur të vitit 2022, duke siguruar likuiditetin e nevojshëm për shoqërinë FSHU sh.a., me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, kërkesë kjo e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, duke mbajtur njëkohësisht të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike prej 9,5 lekë/kWh për konsumin deri në 800 kWh/muaj të klientëve familjarë.

SHEMBULLI LLOGARITJES SË FATURËS SË ENERGISË ELEKTRIKE

Një klient familjar gjatë muajit tetor 2022 ka konsumuar 850 kWh. Fatura e tij e energjisë elektrike do të llogaritet si vijon:

800 kWh x 9.5 lekë/kWh = 7600 lekë

50 kWh x 42 lekë/kWh = 2100 lekë

T.V.SH (20%) = 1940 lekë

Taksa e televizorit = 100 lekë

TOTALI PËR TU PAGUAR = 11740 lekë